



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.117/2024
Datë: 23 prill 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 24 par 1 pika 1.1, nenit 25 par 7 të Rregullores Nr.15/2022 për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin Transferimin, Trajnimet dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës të Bashkëpunëtorit Profesional, në takimin 325, të mbajtur me datë 23 prill 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e z. Albrim Kastrati, bashkëpunëtor profesional, për transfer të përhershëm nga Gjykata Themelore Prishtinë – dega Fushë Kosovë, në Gjykatën Themelore Prishtinë.
- II. Z. Kastrati, do të filloj punën në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nga data 1 maj 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 23 prill 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e datës 27 nëntor 2023, ka marrë vendim KGJK.nr.526/2023 për shpallje të shprehje të interesit për transferimin e përhershëm të bashkëpunëtorëve profesional në gjykatat themelore/ degë. Për të shqyrtuar kërkesat e bashkëpunëtorëve profesional, dhe për të vlerësuar plotësimin e kushteve për transfer, Këshilli ka themeluar Komisionin për trajtimin e kërkesave të tilla.

Komisioni, pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së z. Kastrati, duke e marrë për bazë si përparësi, vlerësimin e performancës, kohëzgjatjen e përvojës së punës si bashkëpunëtor profesional dhe largësinë e udhëtimit nga vendbanimi, i ka rekomanduar KGJK-së, të aprovoj kërkesën për transfer.

Këshilli, në takimin e datës 23 prill 2024, e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit dhe e ka aprovuar kërkesën për transfer.

Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Albrim Kastrati;
- Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit.